

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionalë, Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B., nga fshati ..., Komuna e Shtime, për shkak të veprës penale–mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarit N.B., përmes av. K.A., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR nr.196/16 të datës 09.02. 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 30 tetor 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e të akuzuarit N.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR nr.196/16 të datës 09.02. 2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin PKR nr.196/16 të datës 09.02.2017, të akuzuarin N.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat verifikues prej një viti nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale. Konform dispozitës së nenit 374 par. 3 të KPRK të akuzuarit i është konfiskuar në mënyrë të përhershme pushka e gjuetisë e tipit ‘‘Bokericë’’kal. 12 mm, me nr. serik 128865 dhe 3 fishek të kalibrit 12 mm. I akuzuari është obliguar që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi ta merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-I akuzuari për shkak të vendimit për dënim dhe vendimit për konfiskim në mënyrë të përhershme të pushkës së gjuetisë, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë duke i shqiptuar dënim të kushtëzuar në kohëzgjatje më të shkurtër dhe ti mundësohet kthimi i armës së konfiskuar.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA/I.nr 466/17 të dt. 24.10.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën palët nuk janë njoftuar sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me kusht, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, atëherë Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit i kësaj Gjykate, ngase në këtë drejtim nuk ka pasur ankesë e as që lejohet ankesa pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë - neni 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me kushte i cili nuk është në proporcion me peshën e kësaj vepre sepse i akuzuari deri në vitin 2005 pushkën e gjuetisë e kishte me leje të organit kompetent dhe duke pranuar fajësinë ka shpreh pendimin dhe keqardhjen për veprën e kryer, andaj një dënim minimal me kusht do të ishte edhe në proporcion me rrethanat faktike të rastit konkret dhe i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit. Ndërsa përkitazi me dënimin plotësues thekson se ai nga neglizhenca nuk e kishte vazhduar lejen për pushkën e gjuetisë e jo për ndonjë qëllim ose pengesë ligjore.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e dënimit konform nenit 73 të KPK-së, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar: pendimin e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, gjendjen e dobët ekonomike dhe në mungesë të rrethanave posaçërisht rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe shkallën e rrezikshmërisë konkrete të veprës penale. Vlerësimin e tillë të rrethanave për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe Gjykata e Apelit, e cila gjen se dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së.

Po ashtu Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim plotësues -konfiskim në mënyrë të përhershme të armës, objekt të veprës penale, sepse ky është detyrim ligjorë sipas dispozitës së nenit 374 par. 3 të KPRK, dispozitë kjo që parashikon:” Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet”, prandaj edhe këto pretendime ankimore janë të pabazuara.

Për këto arsye ankesa e të akuzuarit përkitazi me vendimin mbi dënimin u refuzua si e pabazuara.

Nga çka u tha si me lartë konform nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr. 496/2017 i datës 30.10.2017

Procesmbajtësi:

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj_____

Have Haliti_____

Kryetari i kolegjit:

Xhevdet Abazi